



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**PËR:** Deputetët e Kuvendit

**CC:** Kryesisë së Kuvendit

**NGA:** Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

**LËNDA:** Raport me rekomandim për Projektligjin nr.08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare

**DATË:** 10.10.2023

---

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10.10.2023, e shqyrtoi Projektligjin nr.08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

**R e k o m a n d i m**

- I. Të miratohet, në parim, Projektligji nr.08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare;
- II. Të ngarkohet Komisioni përgjegjës-raportues, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

**Arsyetim**

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, para shqyrtimit të parë të Projektligjit, në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 74. 2 dhe 76.2 të Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi në parim Projektligjin e theksuar dhe konstatoi se i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim. Duke pas parasysh që projektligji rregullon çështje që nuk bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, i rekomandoj Kuvendit që pas miratimit në parim të ngarkojë Komisioni përgjegjës-raportues, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Arsyetimin e raportit në Kuvend do ta paraqesë, Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

---